



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

Autoriteti i Konkurrencës me shkresën Nr. 280 Prot., protokoll i AK, datë 23.04.2019 “Njoftim Bashkimi”, është njoftuar në lidhje me transaksionin që konsiston në krijimin e ndërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota në Republikën Popullore të Kinës nga ana e Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

Palët në transaksion janë:

Daimler AG është një shoqëri aksionare, themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit Gjerman. Daimler, së bashku me filialet e saj, operon në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen kryesisht të makinave për pasagjerë dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbime financiare për automjetet, duke përfshirë financime, qira financiare, sigurimin dhe shërbime për menaxhimin e flotave.

Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd është një shoqëri aksionare e regjistruar në Republikën Popullore të Kinës. Zhejiang Geely Holding Group CO., Ltd është një prodhues i automobilave i angazhuar në prodhimin dhe shitjen e automjeteve të pasagjerëve në mbarë botën.

Palët e mësipërme, së bashku, do të krijojnë një shoqëri të përbashkët, me funksione të plota (joint venture), të quajtur Smart Automobile Co., Ltd, e cila do të jetë kryesisht aktive në prodhimin dhe në shpërndarjen e automjeteve elektrike me bateri të pastra, duke përfshirë edhe ofrimin e shërbimeve pas shitjes, në Kinë dhe në Bashkimin Evropian.

Në datën 26 mars 2019 është nënshkruar dokumenti “Kontratë Sipërmarrje të Përbashkët” ndërmjet shoqërive Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

Palët pranojnë të themelojnë një shoqëri me sipërmarrje të përbashkët “Smart Automobile Co.,Ltd”. Shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd do të ketë secili në pronësi 50% të aksioneve në joint venture.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.